



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**RREGULLA PËR ZHVILLIMIN E PROFILEVE KARAKTERISTIKE TË NGARKESAVE NË SISTEMIN  
ENERGJETIK NË KOSOVË**

Prishtinë, qershor 2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, në pajtim me nenin 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, nenin 25, nenin 26, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë nr. 05/L-084, neni 28, nënparagrafi 1.29 i Ligjit për Energjinë Elektrike Nr. 05/L-085, në seancën e mbajtur më 24.06.2022, miratoi:

## **RREGULLA PËR ZHVILLIMIN E PROFILEVE KARAKTERISTIKE TË NGARKESAVE NË SISTEMIN ENERGETIK NË KOSOVË**

### **KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1 Qëllimi, objektivat dhe fushëveprimi**

1. Kjo Rregull specifikon kërkesat për zhvillimin dhe zbatimin e profileve karakteristike të ngarkesave të grupeve të konsumatorëve që nuk janë të pajisur me njehsorë intervali, si dhe zhvillimin e përmbajtjes, përpunimit të të dhënave, metodologjisë dhe afatit kohor për përditësimin e këtyre profileve për konsumatorët e pajisur me njehsorë interval.
2. Objektivat e kësaj Rregulle janë:
  - 2.1. Krijimi i kushteve për pjesëmarrjen në treg për konsumatorët fundor;
  - 2.2. Llogaritja e ngarkesës së konsumatorëve fundorë që nuk janë pajisur me njehsorë intervali;
  - 2.3. Të kuptuarit e sjelljes së konsumatorëve;
  - 2.4. Menaxhimi i konsumit dhe parashikimi i ngarkesës;
  - 2.5. Llogaritja e disbalancës për barazimin e konsumit të furnizuesve;
  - 2.6. Përmirësimi i shpërndarjes së saktë të kostove sipas kategorive dhe grupeve të konsumit, d.m.th. përcaktimi i shkallës së tarifave për shfrytëzuesit e sistemit të shpërndarjes;
  - 2.7. Identifikimi i nevojave për ndryshime të mundshme në dizajnimin e tarifave;
  - 2.8. Planifikimi i ndërtimit të sistemit, dhe
  - 2.9. Analiza dhe planifikimi i humbjeve të shpërndarjes.

3. Kjo rregull përcakton

- 3.1. Procesin e zhvillimit të profileve karakteristike të ngarkesave;
- 3.2. Detyrimet e OSSh-së për zhvillimin dhe publikimin e profileve të karakteristike të ngarkesave;
- 3.3. Metodatat për ndërtimin e profileve të normalizuara të ngarkesave;
- 3.4. Numri i profileve të ngarkesës karakteristike për grupe të ndryshme të konsumatorëve;
- 3.5. Intervalet dhe sezonaliteti i profileve të ngarkesës ditore;
- 3.6. Brezat e konsumit për grupe të ndryshme të konsumatorëve;
- 3.7. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave për zhvillimin e profileve të ngarkesës;
- 3.8. Raportimi i OSSh-së dhe detyrimet ndaj palëve.

## Neni 2

### Përkufizimet dhe Interpretimet

1. Termat e përdorur në këtë Rregull kanë kuptimin e mëposhtëm:

- 1.1. **Leximi Automatik i Njehsorëve (ose AMR)** është një sistem që lexon automatikisht njehsorët interval që janë instaluar në objektet e konsumatorëve dhe kanë mundësi leximi nga distanca;
- 1.2. **Diagrami i ngarkesës bazë** nënkupton një grup të dhënash mbi diagramet përfundimtare të ngarkesës të kategorive dhe grupeve të konsumit;
- 1.3. **Pala Përgjegjëse për Balancim (PPB ose në Anglisht BRP)** është një palë tregtuese që vepron për vete ose në emër të një grupi balancues për qëllime të grumbullimit të disbalancave dhe pagesave të jobalancit, në përputhje me Rregullat në fuqi të Tregut;
- 1.4. **Profilet karakteristike të ngarkesës (ose CLP)** janë diagrame të ngarkesave të përgatitura nga OSSH-ja që paraqesin vlerat mesatare të ngarkesave të mostrave të një grupi apo nëngrupi të konsumit.
- 1.5. **Grupi i konsumit** nënkupton një grup të konsumatorëve fundorë brenda kategorisë së konsumit të përzgjedhur sipas metodës së matjes së energjisë dhe fuqisë aktive, qëllimit të shfrytëzimit të objektit dhe ngarkesës maksimale, siç është përcaktuar me Metodologjinë e Tarifave;
- 1.6. **Kategoria e konsumit** nënkupton kategorinë e konsumatorëve fundorë me karakteristika të ngjashme të konsumit të energjisë elektrike, në varësi të tensionit në vendin e grumbullimit të të dhënave dhe qëllimit të përdorimit të energjisë elektrike;

- 1.7. **Intervali i besimit** – nënkupton përqindjen e probabilitetit, ose sigurisë së matjeve të të dhënave të mbledhura, e cila zakonisht është nivel i besimit 90% ose 95%;
  - 1.8. **OSSH** – nënkupton Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes i licencuar nga ZRRE;
  - 1.9. **Databazë** nënkupton një grup të dhënash të formuara për karakteristikat e konsumatoreve, të dhënat e matjes dhe faturimit, të dhënat e kushteve meteorologjike, të dhënat për konsumatorët fundorë të mostruar, të dhënat e leximit nga distanca të konsumatorëve fundorë të mostruar, të dhënat për diagramet karakteristike të ngarkesave dhe diagramet e ngarkesës;
  - 1.10. **ZRRE** – nënkupton agjencinë e pavarur për sektorin energjetik të Kosovës, e themeluar me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë;
  - 1.11. **Njehsorë intervali** janë njehsorë që instalohen në objektet e konsumatoreve dhe regjistrojnë se sa energji/fuqi elektrike çdo 15, 30 ose 60 minuta;
  - 1.12. **Diagrami i ngarkesës nënkupton** një diagram të niveleve të ngarkesës për orë gjatë periudhës kohore ditore, javore, mujore ose vjetore, e bërë në bazë të të dhënave të marra nga njehsori interval;
  - 1.13. **Cikli i matjes** nënkupton periudhën kohore për mbledhjen e të dhënave për leximet e mostrave për konsumatorët fundorë;
  - 1.14. **Intervali i matjes** nënkupton periudhën e caktuar kohore të matjes së energjisë/fuqisë (15 min., 30 min. ose 60 min);
  - 1.15. **Faktori i saktësisë** nënkupton përqindjen e miratuar të gabimit të lejuar që përcakton numrin e kërkuar të mostrave sipas kategorive, grupeve ose nëngrupeve të konsumit;
  - 1.16. **Leximi nga distanca** nënkupton mbledhjen e të dhënave nga distanca nga njehsorët interval me mundësi leximi nga distanca duke përdorur një nga mënyrat e mundshme të komunikimit mes qendrës AMR dhe njehsorit interval me lexim nga distanca;
  - 1.17. **Stratifikimi (Shtresëzimi)** është ndarja e popullsisë (popullsia është term statistikor që, në këtë rast, i referohet numrit total të konsumatorëve brenda çdo kategorie konsumatore që i nënshtrohet mostrës së hulumtimit të ngarkesës) në grupe ekskluzive të veçanta, jo-konkurrese të quajtura shtresa (stratume). Nëse grupet individuale (shtresat) janë më homogjene se vetë popullata, atëherë kjo mund të rrisë saktësinë e vlerësimit të mostrës së popullsisë dhe/ose të zvogëlojë madhësinë e përgjithshme të mostrës së kërkuar.
2. Termat tjera të përdorura në këtë Rregull kanë kuptimin sikurse në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, Ligjin për Energjinë Nr. 05/L-081, Ligjin për Energjinë Elektrike Nr. 05/L – 085 dhe ligje të tjera të aplikueshme në Kosovë.

KAPITULLI II  
SISTEMI I MATJES

**Neni 3**  
**Instalimi i Sistemit Matës Interval**

1. Instalimi i Njehsorëve Interval për konsumatorët e lidhur në rrjetin e sistemit të distribucionit nevojitet për këto kategori:
  - 1.1. Të gjithë konsumatorët e lidhur në 35 kV dhe 10(20) kV (grupi tarifor 1 dhe 2);
  - 1.2. Të gjithë konsumatorët komercialë të lidhur në 0.4kV (me shfrytëzim të energjisë reaktive) – grupi tarifor 3;
  - 1.3. Të gjithë konsumatorët komercialë të grupit tarifor 4 (7/01 dhe 7/02) me konsum vjetor mbi 50.000 KWh;
  - 1.4. Të gjithë konsumatorët e amvisërive me konsum vjetor mbi 20.000 KWh – grupi tarifor 5 dhe 6 (4/01 dhe 4/02).
  - 1.5. Ndriçimi publik me konsum vjetor mbi 20.000 KWh.
2. Për kategoritë e konsumatorëve të identifikuar në paragrafin 1 të këtij neni, OSSH-ja brenda 3 muajsh pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle duhet të paraqes tek ZRRE-ja planin me afatet kohore për instalimin e Njehsorëve Interval dhe planin për zhvillimet e nevojshme në teknologji informative;
3. ZRRE-ja do të shqyrtojë planin e OSSH-së siç përshkruhet në paragrafin 2 të këtij neni dhe nxjerr një vendim me një afat të arsyeshëm për instalimin e Njehsorëve Interval.

**Neni 4**  
**Leximi i Njehsorëve Interval dhe përpunimi i të dhënave**

1. Leximi i të dhënave për konsumatorët e pajisur me Njehsor Interval të referuar në nenin 3 të kësaj Rregulle duhet të jetë si në vijim:
  - 1.1 OSSH-ja mbledh të dhëna të matjes nga Njehsorët e Intervalit me lexim nga distanca;
  - 1.2 Në rast se leximi nga distanca nuk është i mundshëm, OSSH-ja merr të dhënat e matjes direkt nga memoria e njehsorit. Marrja e të dhënave të matjes nga memoria e Njehsorit të Intervalit duhet të përputhet me periudhat mujore të leximit

2. Të dhënat e mbledhura nga njehsorët e konsumatorëve fundorë të referuar në këtë nen përpunohet dhe ruhet në një databazë të krijuar dhe mirëmbajtur nga OSSh-ja.

### KAPITULLI III ZHVILLIMI I PROFILEVE TË NGARKESËS

#### Neni 5

#### **Përgatitja e Profileve të Ngarkesës për konsumatorët me Njehsor Interval**

Bazuar në të dhënat e mbledhura nga konsumatorët e pajisur me Njehsor Interval me lexim nga distanca, të referuar në nenin 4 të kësaj Rregulle, OSSh-ja duhet të përgatis dhe publikojë profilet e ngarkesës së këtyre konsumatorëve në forme agregate grafike dhe tabelare.

#### Neni 6

#### **Zhvillimi i Profileve Karakteristike të Ngarkesave**

1. Për konsumatorët që nuk janë të pajisur me Njehsor Interval sipas nenit 3, OSSh-ja gjithashtu duhet të zhvillojë Profile Karakteristike të Ngarkesave.
2. OSSh-ja duhet të zhvillojë Profile Karakteristike të Ngarkesave për këto grupe të konsumatorëve që nuk janë të pajisur me Njehsor Interval deri në instalimin e njehsorëve interval:
  - 2.1. Grupi tarifor 4 i konsumatorëve komercialë (7/01 dhe 7/02) me konsum vjetor nën 50.000 kWh;
  - 2.2. Grupi tarifor 5 dhe 6 i konsumatorëve të amvisërive (4/01 dhe 4/02) me konsum vjetor nën 20.000 kWh; dhe
  - 2.3. Grupi tarifor 8 i ndriçimit publik me konsum vjetor nën 20.000 kWh.

#### Neni 7

#### **Metodat për zhvillimin e Profileve Karakteristike të Ngarkesave**

1. Profilet karakteristike të ngarkesave për të gjithë konsumatorët fundorë që nuk janë të pajisur me njehsor interval do të llogariten në bazë të të dhënave të grumbulluara të

konsumatorët fundorë të mostruar në ciklin e matjeve të kryera në periudhë njëvjeçare. Ciklet e matjes duhet të aktivizohen çdo dy vjet.

2. Në ciklin e parë të matjes, OSSh-ja duhet të zhvillojë profilet karakteristike të ngarkesave për orë për çdo ditë të vitit kalendarik.
3. Metodologjia për zhvillimin e profileve karakteristike të ngarkesave së konsumatorëve fundorë të mostrës përbëhet prej hapave të mëposhtëm:

*3.1 Përcaktimi i pranueshmërisë të profilit të ngarkesës ditore,*

Për çdo konsumator me njehsorë intervali (nga kategoria e konsumit të vëzhguar), merren parasysh vetëm ditët që plotësojnë kriterin e pranueshmërisë së numrit të lejuar të të dhënave të njëpasnjëshme që mungojnë; d.m.th. deri në tetë periudha 15-minutëshe të njëpasnjëshme, pra dy orë rresht ("ditë të pranueshme");

*3.2 Përfshirja (Plotësimi) e të dhënave që mungojnë (boshllëqet në profilet e ngarkesës së matur):*

Boshllëqet e vogla ( $\leq 2$  orë) në profilet e ngarkesës ditore duhet të plotësohen përmes plotësimit linear (shpjegimet në Shtojcën 1);

*3.3 Përcaktimi i profileve karakteristike të ngarkesës ditore për çdo konsumator:*

Bazuar në profilet e ngarkesës ditore të ditëve të pranueshme, për çdo konsumator përcaktohen  $12 \times 3 = 36$  profile të ngarkesës ditore, të cilat janë profile tipike ditore për 12 muaj kalendarikë dhe tre ditë tipike javore (ditë pune, e shtunë dhe e diel/festë):

- $PN_{DPI}(t)$  (Profili i ngarkesës për ditë pune)
- $PN_{SHI}(t)$  (Profili i ngarkesës për të shtunën)
- $PN_{DI}(t)$  Profili i Ngarkesës e diel/festë).

Edhe nëse konsumatorët individualë kanë matje 15-minutëshe, gjysmorëshe ose njëorëshe, PN-të e ditëve tipike do të jenë profile për orë (24 vlera) të shprehura në kWh për orë si rezultat i këtij hapi të procedurës;

*3.4 Përcaktimi i profileve të ngarkesës karakteristike për çdo kategori konsumi:*

Për çdo konsumator në kategorinë e konsumit të vëzhguar, përcaktohen  $12 \times 3 = 36$  profile karakteristike të ngarkesës (PKN). Ato paraqesin profilin mesatar ditor të ngarkesës në muajin kalendarik të vëzhguar për çdo ditë karakteristike (ditë pune, e shtunë dhe e diel/festë).

Profilet e ngarkesës karakteristike duhet të ndahen në 4 sezona:

- o Sezoni i pranverës,
- o Sezoni i verës,
- o Sezoni i vjeshtës,
- o Sezoni i dimrit.

4. Ilustrimi i metodologjisë dhe shembulli i mostrës janë dhënë në Aneksin 1 të kësaj Rregulle.

## **Neni 8**

### **Përzgjedhja e mostrave**

1. Gjatë procesit të zhvillimit të profileve karakteristike të ngarkesave, OSSh-ja duhet të planifikojë përzgjedhjen e mostrave për kategori, grupe dhe nëngrupe të ndryshme të konsumit.
2. Kur përzgjidhen mostrat, OSSh-ja është e obliguar që të marrë parasysh nëse mostrat përfundimtare janë konsumatorë të mostruar që janë përfaqësim tipik të kategorisë së konsumit, grupit ose nëngrupit të konsumit.
3. OSSh-ja duhet të shfrytëzojë metodat e njohura kur përzgjidhen mostrat, duke marrë parasysh kriteret e cilësisë, numrin e konsumatorëve të mostruar dhe arsyetimin ekonomik;
4. OSSh-ja duhet të përzgjedh mostrat sipas kriterëve të mëposhtme:
  - 4.1. Sasia e konsumit të energjisë elektrike;
  - 4.2. Metoda e konsumit (a përdoret energjia elektrike për ngrohje/ftohje);
  - 4.3. Lloji i matjes së konsumit;
  - 4.4. Lloji i objektit (industrial, komercial, shtëpiak – përkatësisht sipas grupeve tarifore);
  - 4.5. Lloji i vendbanimeve, dhe
  - 4.6. Lokacioni gjeografik
5. Numri i mostrave për kategori, grupi, ose nëngrup të konsumit të OSSh-së përcaktohet në bazë të:
  - 5.1. Faktorët e saktësisë (dmth gabimi maksimal i lejuar) – zakonisht 5%, 10%, 15 ose 20%; dhe
  - 5.2. Intervali i besimit – zakonisht 90% ose 95%



## Neni 9 Metodologjia e mostrimit

Në metodologjinë e mostrimit për zhvillimin e profileve të ngarkesës karakteristike të referuar në nenin 8 duhet të merren parasysh:

- Mostrimi në nivel vendi (shteti) të kategorive të ndryshme të konsumatorëve;
- Përfshirja e konsumatorëve në të gjitha kategoritë me konsum vjetor 0, dhe deri në 1.000 kWh
- Përfshirja e konsumatorëve me konsum vjetor mbi kufirin e referuar në nenin 3 të kësaj Rregulle;
- Shfrytëzimi i metodologjisë së shtresuar (stratified) të mostrës së rastit sipas përkufizimit në Nenin 2, paragrafi 2.17 të kësaj rregulle;

## Neni 10 Numri i Profileve të Ngarkesës për konsumatorët e pajisur me njëhisorë intervali

1. OSSh-ja duhet të publikojë ne ueb-faqen zyrtare, profilet përfaqësuese të ngarkesës për konsumatorët e pajisur me njëhisorë të intervalit të referuar në nenin 3 të këtij Rregulli si në vijim:
  - 1.1. Dy (2) profile përfaqësuese për konsumatorët e lidhur në 35 kV (grupi tarifar1/2):
    - 1.1.1. Konsumatorët me konsum vjetor  $\leq 600.000$  (kWh) dhe
    - 1.1.2. Konsumatorët me konsum vjetor  $> 600.000$  (kWh);
  - 1.2. Pesë (5) profile përfaqësuese për konsumatorët e lidhur në 10 (20) kV (grupi tarifar1/3):
    - 1.1.1. Konsumatorët me konsum vjetor  $\leq 60.000$  (kWh);
    - 1.1.2. Konsumatorët me konsum vjetor  $> 60.000$  (kWh) dhe  $\leq 120.000$  (kWh);
    - 1.1.3. Konsumatorët me konsum vjetor  $> 120.000$  (kWh) dhe  $\leq 360.000$  (kWh);
    - 1.1.4. Konsumatorët me konsum vjetor  $> 360.000$  (kWh) dhe  $\leq 600.000$  (kWh), dhe
    - 1.1.5. Konsumatorët me konsum vjetor mbi 600.000 (kWh).
  - 1.3. Pesë (5) profile përfaqësuese për konsumatorët komercialë të lidhur në 04 kV (me shfrytëzim të energjisë reaktive grupi tarifar 3):
    - 1.1.1. Konsumatorët me konsum vjetor  $\leq 9.600$  (kWh);
    - 1.1.2. Konsumatorët me konsum vjetor  $> 9.600$  (kWh) dhe  $\leq 36.000$  (kWh);
    - 1.1.3. Konsumatorët me konsum vjetor  $> 36.000$  (kWh) dhe  $\leq 120.000$  (kWh);
    - 1.1.4. Konsumatorët me konsum vjetor  $> 120.000$  (kWh) dhe  $\leq 600.000$  (kWh), dhe
    - 1.1.5. Konsumatorët me konsum vjetor mbi 600.000 (kWh)

- 1.4. Katër (4) profile përfaqësuese për konsumatorët komercialë të lidhur në 04 kV (grupi tarifor 7/01 dhe 7/02):
  - 1.1.1. Konsumatorët me konsum vjetor >50.000 (kWh) dhe ≤ 60.000 (kWh);
  - 1.1.2. Konsumatorët me konsum vjetor > 60.000 (kWh) dhe ≤ 120.000 (kWh);
  - 1.1.3. Konsumatorët me konsum vjetor >120.000 (kWh) dhe ≤ 180.000 (kWh), dhe
  - 1.1.4. Konsumatorët me konsum vjetor mbi 180.000 (kWh).
- 1.5. Një (1) për ndriçimin publik me konsum vjetor mbi 20.000 kWh.

### **Neni 11**

#### **Numri i Profileve Karakteristike të Ngarkesave për grupe të ndryshme të konsumatorëve**

1. OSSh-ja do të zhvillojë 10 profile karakteristike të ngarkesave për grupe të ndryshme të konsumatorëve pa njehsorë të intervalit si në vijim:
  - 1.1. Gjashtë (6) për konsumatorë komercial grupi tarifor 4 (7/01 dhe 7/02):
    - 1.1.1. Zyre;
    - 1.1.2. Institucionet, publike dhe private (shkollat, çerdhet, universitetet, qendrat shëndetësore, spitalet, shtëpitë për të moshuar etj);
    - 1.1.3. Kafiteritë & restorantet;
    - 1.1.4. Furrat & ëmbëltoret;
    - 1.1.5. Tregjet dhe shitoret;
    - 1.1.6. Bizneset e vogla (shitoret) me konsum vjetor deri në 5000 kWh.
  - 1.2. Tri (3) për konsumatorët e amvisërive grupi tarifor 5 dhe 6 (4/01 dhe 4/02):
    - 1.1.1. Konsumatorët me konsum vjetor deri në 7.200 kWh;
    - 1.1.2. Konsumatorët me konsum vjetor deri në 12.000 kWh;
    - 1.1.3. Konsumatorët me konsum vjetor deri në 20.000 kWh.
  - 1.3. Një (1) për ndriçimin publik me konsum vjetor nën 20.000 kWh.

### **KAPITULLI IV**

#### **DATABAZA PËR PROFILET E NGARKESËS**

### **Neni 12**

#### **Databaza për zhvillimin e Profileve Karakteristike të Ngarkesave**

1. OSSh-ja planifikon, kryen dhe zbaton ciklin e matjes në përputhje me planin dhe aktivitetet

- e caktuara për zhvillimin e profileve karakteristike të ngarkesave.
2. Gjatë gjithë ciklit të matjes, të dhënat e OSSh-së tentohet lexim nje here ne dite per ditën paraprake dhe raportohet për çdo pikë të matjes të konsumatorit të mostruar në intervale 60 minutëshe.
  3. OSSh-ja mbledh të dhëna nga njehsorët bazuar në pajisjet e instaluar të referuara në nenin 4 të kësaj Rregulle.
  4. Të dhënat e mbledhura shërbejnë si bazë për zhvillimin e diagrameve të ngarkesës karakteristike, që përfshin energjinë aktive dhe vlerat e energjisë me afatet e grumbullimit për konsumatorët e mostruar fundorë me njehsorë interval.
  5. OSSh-ja duhet të realizojë një procedurë të procesimit për të gjitha të dhënat e grumbulluara per ngarkese , si dhe vlerësimin dhe editimin e raportit te të dhënave.
  6. OSSh-ja duhet të zhvillojë dhe mirëmbajë një databazë për Profilet Karakteristike të Ngarkesave, duke instaluar një softuer të cilësisë së lartë për shkarkimin, ruajtjen dhe procesimin e të dhënave.
  7. Të dhënat në databazë përfshijnë të dhënat e matjeve të konsumatorët fundorë që kanë të instaluar njehsorë interval, të dhënat e matjes nga konsumatorët fundorë të mostruar, diagramet e ngarkesës, si dhe vlerat e llogaritura bazuar në procesimin e të dhënave të lexuara nga distanca të mostrave nga konsumatorët fundorë.
  8. Databaza e diagramit të ngarkesës përfshin:
    - 8.1. Diagramet e regjistruara të ngarkesës për konsumatorët fundorë me njehsorë të interval.
    - 8.2. Diagramet e ngarkesës karakteristike për kategori dhe grupe të konsumit që nuk kanë obligim për të instaluar njehsorë interval, dhe
    - 8.3. Diagramin e ngarkesës të sistemit të shpërndarjes.

### **Neni 13**

#### **Të dhënat meteorologjike dhe të dhënat për karakteristikat e konsumatorëve fundorë të mostruar**

1. Gjatë ciklit të matjes, OSSh-ja duhet të shkarkojë dhe ruajë vazhdimisht të dhëna nga institucionet kompetente relavante për intervalet e matjes për temperaturën e ajrit dhe kushtet e motit për të gjitha zonat gjeografike ku maten konsumatorët e mostruar fundorë.
2. Kur parashikohet konsumi dhe ngarkesat, shfrytëzohen të dhënat nga databaza për temperaturën e ajrit dhe kushtet e motit si dhe databaza për karakteristikat e konsumatorëve të mostruar fundorë.

**Neni 14**  
**Çasja në të dhënat e databazës**

1. OSSH-ja krijon dhe mirëmban databazën për Profilet e Ngarkesës Karakteristike në përputhje me kushtet e ligjit (nr. 06/L-082) për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
2. Sipas rregullave të përkufizuara të procedurës për formimin dhe menaxhimin e databazës dhe shërbimin e shfrytëzuesve të databazës, këto subjekte kanë të drejtë të shfrytëzojnë të dhënat:
  - 2.1. Zyra e Rregullatorit për Energji;
  - 2.2. Sistemi i Transmisionit dhe Operatorit i Sistemit të Tregut (KOSTT);
  - 2.3. Pala Përgjegjëse për Balancë (më tutje PPB);
  - 2.4. Furnizuesit e licencuar për të furnizuar konsumatorët fundorë të lidhur në rrjetin e distribucionit të OSSH-së, dhe
  - 2.5. Konsumatorët fundorë të lidhur në rrjetin e distribucionit të OSSH-së.
3. Mënyra dhe kushtet për shfrytëzimin e databazës së OSSH-së do të rregullohen me marrëveshje reciproke në mes të shfrytëzuesve të databazës në përputhje me dispozitat e ligjeve primare të energjisë, rregullave dhe rregulloreve në sektorin e energjisë dhe kodeve si dhe në përputhje me aktet relevante që rregullojnë mënyrën e ruajtjes dhe shfrytëzimit të procesimit të të dhënave personale.

**OBLIGIMET E OSSH-SË DHE RAPORTIMI**

**Neni 15**  
**Obligimet e OSSH-së**

1. Në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulle, OSSH-ja i ka këto obligime:
  - 1.1. Ofrojë kushte për lexim të vazhdueshëm nga Njehsorët Interval për konsumatorët fundorë;
  - 1.2. Ofrojë infrastrukturën e nevojshme për të realizuar ciklin e matjes; 1.3.Përkufizojë metodat e ciklit të matjes, afatet dhe monitorimin; 1.4.Krijojë një raport për përzgjedhjen e mostrës;
  - 1.3. Planifikojë dhe drejtojë tërë procesin e krijimit të diagrameve karakteristike të ngarkesave;

- 1.4. Krijojë dhe zbatojë një procedurë për krijimin dhe zbatimin e profileve karakteristike të ngarkesave;
- 1.5. Krijojë një raport për ciklin e përfunduar të matjes;
- 1.6. Krijojë një procedurë për krijimin e databazave, menaxhimin e tyre dhe ofrimin e mbështetjes për shfrytëzuesit e databazës, informatat dhe
- 1.7. Krijojë dhe menaxhojë databazat dhe t'u ofrojë shfrytëzuesve të autorizuar shërbimet e databazës.
- 1.8. Përgatisë Profilet Karakteristike të Ngarkesave për çdo kategori të konsumatorëve për një periudhë prej të paktën një vit kalendarik.

### **Neni 16** **Raportet e OSSh-së**

1. OSSh-ja duhet të dorëzojë raporte të përzgjedhjes së mostrës tek ZRRE-ja për shqyrtim jo më vonë se 30 ditë para fillimit të ciklit të matjes, bashkë me një sqarim të faktorëve të precizitetit dhe intervalit të besimit që shfrytëzohen. Raporti nuk duhet ta kufizojë OSSh-në që në mënyrë të qartë të përkufizojë kriteret, ndërsa mostrat mund të ndryshohen dhe/ose modifikohen për të prodhuar diagrame të cilësisë së lartë për të paraqitur ngarkesën, të cilat duhet të raportohen tek ZRRE-ja pa vonesë.
2. OSSh-ja duhet të parashtrijë raporte për ciklin e përfunduar të matjes tek ZRRE-ja jo më vonë se 60 ditë pas përfundimit të ciklit të matjes, të cilat duhet të përfshijnë këto informata:
  - 2.1. Diagrame të normalizuara të ngarkesës të konsumatorëve me Njehsor Interval;
  - 2.2. Diagramet karakteristike të ngarkesave bazuar në kategoritë dhe grupet e konsumit;
  - 2.3. Analiza e ndikimit e rezultateve të fituara dhe karakteristikat e diagramit të ngarkesës dhe sa i përket ngarkesës totale të sistemit.
  - 2.4. Një ekzaminim i efektit të kategorive dhe grupeve të konsumit për ngarkesën totale të sistemit për caktimin e kostos për kapacitetin e distribucionit, dhe
  - 2.5. Propozimi për formimin e grupeve ose nëngrupeve të tjera të konsumatorëve për të arritur cilësinë më të lartë në krijimin e diagrameve të ngarkesës.

**Neni 17**  
**Obligimet e OSSh-së kundrejt pjesëmarrësve të tregut**

1. Brenda afatit të përcaktuar nga KOSTT-i, OSSh-ja do të paraqesë ngarkesën e realizimit për orë për çdo furnizues individual në baza ditore.
2. Në fund të çdo muaji, OSSh-ja do të parashtojë tek KOSTT-i të dhënat e realizura për orë dhe ditë nga secili furnizues.
3. OSSh-ja do t'i ofrojë PPB-së një llogaritje të ngarkesave të realizuara për orë për çdo ditë për secilin furnizues me të cilin PPB-ja ka marrëdhënie kontraktuale.
4. OSSh-ja do t'i ofrojë secilit furnizues ngarkesat e realizuara ditore totale për orë të konsumatorëve me të cilët furnizuesi ka marrëdhënie kontraktuale.
5. OSSh-ja do të publikojë diagramet e ngarkesës të normalizuara dhe karakteristike për çdo kategori dhe grup të konsumatorëve në uebsajtin e saj.

**Neni 18**  
**Ndryshimi**

1. ZRRE-ja ka të drejtë të ndryshojë ose modifikojë çdo dispozitë të kësaj Rregulle.
2. Procedura për ndryshimin ose modifikimin e kësaj Rregulle do të jetë e njëjtë sikurse për miratimin e saj.

**Neni 19**  
**Interpretimi**

Nëse ka paqartësi sa i përket dispozitat të kësaj Rregulle, Bordi i ZRRE-së do të lëshojë informata sqaruese.

**Neni 20**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Rregull hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqën elektronike të ZRRE-së